

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta si kryetare e kolegjit dhe nga gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti (gjyqtar raportues) dhe gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si anëtarë të kolegjit, me ndihmën e zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelmann si procesmbajtës,

në lëndën penale kundër:

1. **K.P.**, emri i babait Z., emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës M.M., i lindur më ... në XXX, Komuna e Y, me vendbanim në Y, Kosovë, shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion ____, me gjendje mesatare ekonomike; Në paraburgim prej datës 24 maj 2012;
2. **L.P.**, emri i babait P., emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës V., i lindur më në Y, Kosovë, me vendbanim të njëjtë, shqiptar i Kosovës, me profesion ____, me gjendje mesatare ekonomike;
3. **B.B.**, emri i babait J., emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës I.D., i lindur më ... në G., me vendbanim në XXX, Kosovë, shqiptar i Kosovës, me profesion ____, me gjendje mesatare ekonomike;

Të tre të pandehurit akuzohen me anë të aktakuzës PPS. Nr. 120/2010, të datës 10 gusht 2011, për kryerje të këtyre veprave penale:

1. **Krim i organizuar** në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës¹ (tash e tutje: KPK), lidhur me të pandehurin **K.P. krim i organizuar** in në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 3 të KPK-së në lidhje me veprat penale të **Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit** në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së dhe **Nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore** në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së;

Përveç kësaj, të pandehurit **K.P.** dhe **L.P.** janë akuzuar për kryerje të veprës penale:

2. **Falsifikimi i dokumenteve** në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 333 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të KPK-së;

Me vendimin KA. Nr. 304/2011, të datës 23 shtator 2011, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës, **hodhi poshtë** akuzën për **Falsifikim të dokumenteve** në bashkëkryerje në

¹ Lëshuar si 'Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës', i nxjerrë i Rregullore e UNMIK-ut 2003/25, e datës 6 korrik 2003, i riemëruar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012

kundërshtim të nenit 333 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, kundër K.P. dhe L.P..

Me aktgjykimin e shkallës së parë **P. Nr. 477/2011 të Gjykatës së Qarkut të Pejës, të datës 24 maj 2012,**

a) I pandehuri **K.P.** shpallet:

- **I pafajshëm** për veprën penale **Krim i organizuar** në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së,

- **Fajtor** për veprën penale të **Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit** në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së,

- Kurse akuzat kundër tij për kryerje të veprës penale **Nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore** në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së janë **refuzuar**.

Ai është dënuar me **(5) vjet burgim** si dhe **me një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të funksioneve publike në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë tre (3) vjeçare** pas vuajtjes së dënimit kryesor.

b) I pandehuri **L.P.** shpallet:

- **Fajtor** për veprën penale të **Mashtrimit** në kundërshtim të nenit 261 paragrafit 1 dhe 2 të KPK-së.

Ai është dënuar me tre (3) vjet burgim si dhe **me një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës për një periudhë tre (3) vjeçare** duke filluar nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë, me kusht që periudha kohore e kaluar në burg nuk përfshihet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues.

c) I pandehuri **B.B.** shpallet:

- **Fajtor** për veprën penale të **Mashtrimit** në kundërshtim të nenit 261 paragrafit 1 dhe 2 të KPK-së.

Ai është dënuar me **gjashtë (6) muaj burgim, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda dy (2) vitesh**. Ndaj tij është shqiptuar **një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës për një periudhë tre (3) vjeçare** duke filluar nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë.

I pandehuri i katërt është liruar nga të gjitha akuzat.

Pas ankesave të paraqitura nga Prokurori Special në emër të tre të pandehurve të dënuar, **Gjykata e Apelit** si gjykatë e shkallës së dytë me **aktgjykimin PAKR. Nr. 1122/2012, të datës 25 prill 2013**, refuzoi ankesat e paraqitura në emër të të pandehurve K.P., L.P. dhe B.B. kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si të pabazuara. Gjykata **ndryshoi** aktgjykimin e shkallës së parë *sipas detyrës zyrtare* siç vijon:

I pandehuri K.P., në vend të veprës penale **Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit**, është shpallur fajtor për veprën penale **Nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore** në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së dhe **është dënuar me pesë (5) vjet burgim**. Në përputhje me nenin 391 paragrafin 5 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës² (tash e tutje: KPPK), koha e kaluar në mbajtje gjatë procedurës paraprake është llogaritur në dënim.

² Lëshuar si 'Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës', i nxjerrë i Rregullore e UNMIK-ut 2003/26, e datës 6 korrik 2003, i riemëruar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-003, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.

Ankesa e prokurorit Special është pranuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar sa i përket lirimit të të pandehurit të katërt. Lënda kundër tij është kthyer për rigjykim në Gjykatë Themelore.

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 26 dhjetor 2013 nga avokati mbrojtës Ramë Gashi në emër të të pandehurit L.P., kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 6 janar 2014 nga i pandehuri L.P., kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 15 janar 2014 nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të të pandehurit B.B. dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 4 shkurt 2014 nga i pandehuri K.P. kundër aktgjykimit të formës së prerë PAKR. Nr. 1122/2012 të Gjykatës së Apelit, të datës 25 prill 2013, dhe kundër aktgjykimit P. Nr. 477/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 24 maj 2012, dhe duke marrë parasysh përgjigjen e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës the (tash e tutje: ZPShK), të paraqitur më 19 gusht 2014,

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura në emër të pandehurit dhe nga i pandehuri L.P. kundër aktgjykimit P. Nr. 477/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 24 maj 2012, dhe kundër aktgjykimit PAKR. Nr. 1122/2012 të Gjykatës së Apelit, të datës 25 prill 2013, REFUZOHEN SI TË PABAZUAR.**
- 2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit B.B. është gjetur si I BAZUAR. Aktgjykimi P.-K. Nr. 477/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i datës 24 maj 2012, dhe aktgjykimi PAKR. Nr. 1122/2012 i Gjykatës së Apelit, i datës 25 prill 2013, NDRYSHOHEN siç vijon:
- *I pandehuri B.B. LIROHET NGA TË GJITHA AKUZAT PENALE.***
- 3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri K.P. është gjetur si PJESËRISHT I BAZUAR. Aktgjykimet e lartpërmendura NDRYSHOHEN sa i përket sanksionit penal si në vijim:
- *I akuzuari K.P. dënohet me katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.***

Pjesa e mbetur e kërkesës REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

- 1) Më 22 shtator 2010 PSRK-ja lëshoi aktvendim për nisjen e hetimit kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe kundër një të bashkëpandehurit tjetër.
- 2) Në gusht 2011 PSRK-ja ngriti para Gjykatës së Qarkut në Pejë aktakuzën PPS. Nr. 120/2010, të datës 10 gusht 2011, duke i akuzuar të tre të pandehurit dhe një të bashkëpandehur tjetër për veprat e lartpërmendura penale.
- 3) Me aktvendimet KA. Nr. 034/2011, të datës 23 shtator dhe 27 dhjetor 2011u konfirmua aktakuza lidhur me akuzat për krim të organizuar në lidhje me veprat penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së dhe nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së, kurse është hedhur poshtë akuza për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 333 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të KPK-së kundër K.P. dhe L.P..
- 4) Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mes 12 mars dhe 24 maj 2012 para Gjykatës së Qarkut në Pejë.
- 5) Më 24 maj 2012 Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi aktgjykimin P. Nr. 477/2011, duke e liruar të pandehurin K.P. nga vepra penale e krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së, dhe duke e shpallur fajtor për kryerje të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 1 dhe 3 të KPK-së, kurse akuzat kundër tij për kryerje të veprës penale nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së janë refuzuar. Ai është dënuar me (5) vjet burgim si dhe me një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të funksioneve publike në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë tre (3) vjeçare pas vuajtjes së dënimit kryesor.
- 6) I pandehuri L.P. është shpallur fajtor për veprën penale të Mashtrimit në kundërshtim të nenit 261 paragrafit 1 dhe 2 të KPK-së, të cilën gjykata e ka ri-cilësuar si krim të organizuar. Ai është dënuar me tre (3) vjet burgim si dhe me një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të profesionit i aktiviteteve ose detyrës për një periudhë tre (3) vjeçare duke filluar nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë, me kusht që periudha kohore e kaluar në burg nuk përfshihet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues.
- 7) I pandehuri B.B. është shpallur fajtor për veprën penale të Mashtrimit në kundërshtim të nenit 261 paragrafit 1 dhe 2 të KPK-së, të cilën gjykata e ka ri-cilësuar si krim të organizuar. Ai është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda dy (2) vitesh. Ndaj tij është shqiptuar një dënim plotësues me ndalim të ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës për një periudhë tre (3) vjeçare duke filluar nga dita kur ky aktgjykim bëhet i formës së prerë. I pandehuri i katërt është liruar nga të gjitha akuzat.
- 8) PSRK-ja dhe të pandehurit K.P., L.P. dhe B.B. kanë paraqitur ankesa kundër këtij aktgjykimi.

9) Më 25 prill 2013 u mbajt seanca publike para Gjykatës së Apelit. Me aktgjykimin PAKR. Nr.1122/2012, të datës 25 prill 2013, Gjykata i refuzoi ankesat e paraqitura në emër të të pandehurve K.P., L.P. dhe B.B. kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si të pabazuara. Gjykata ndryshoi *sipas detyrës zyrtare* aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë siç vijon:

- I pandehuri K.P. është shpallur fajtor për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së dhe është dënuar me pesë (5) vjet burgim. Në përputhje me nenin 391 paragrafin 5 të KPPK-së, koha e kaluar në paraburgim është llogaritur në dënim.

Ankesa e Prokurorit Special është pranuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar sa i përket lirimit të të pandehurit të katërt. Lënda kundër tij është kthyer në Gjykatë Themelore për rigjykim.

10) Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur më 26 dhjetor 2013 nga avokati mbrojtës Ramë Gashi në emër të të pandehurit L.P., më 6 janar 2014 nga vetë i pandehuri L.P., 15 janar 2014 nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të të pandehurit B.B. dhe më 4 shkurt 2014 nga i pandehuri K.P. kundër aktgjykimit të formës së prerë PAKR. Nr. 1122/2012 të Gjykatës së Apelit, të datës 25 prill 2013, dhe kundër aktgjykimit P. Nr. 477/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 24 maj 2012.

11) Përveç këtyre, i pandehuri L.P. ka paraqitur plotësim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 25 shkurt 2014, 28 prill 2014, 18 qershor 2014 dhe 10 korrik 2014.

12) I pandehuri B.B. më 2 tetor 2014 ka paraqitur plotësim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

13) Më 19 gusht 2014 Zyra e kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) ka paraqitur përgjigje.

II. Parashtrësit e palëve

1. Kërkesa e paraqitur nga i pandehuri K.P. më 1 shkurt 2014

14) Me kërkesë propozohet të ndryshohen të dy aktgjykimet e kundërshtuara, ose përndryshe, të anulohen pjesërisht ose tërësisht aktgjykimet dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore të Pejës. I pandehuri K.P. e bazon kërkesën e tij kundër dy aktgjykimeve në shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale dhe në shkelje të ligjit penal.

15) Kërkesa në veçanti pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe shkelje të të drejtave të mbrojtjes sepse janë zhvilluar katër procedura të veçanta penale kundër të pandehurit në vend se të përqendroheshin të gjitha veprat penale në një lëndë dhe të zbatoheshin dispozita e nenit 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (kodi i ri penal, KPRK) për veprat penale në vazhdim. Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit me pranimin se lënda kundër të pandehurit është ndarë në katër lëndë të veçanta (shih kërkesën faqe 3, nr. I. deri IV.) ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale, të ligjit penal dhe të të drejtave të të

pandehurit, në veçanti të nenit 81 të KPRK-së. Lëndët është dashur të bashkoheshin në një lëndë pasi që janë plotësuar të të gjitha elementet e veprës penale në vazhdim.

- 16) Vendimet e kundërshtuara përmbajnë vendime të gabuara lidhur me sanksionet penale në shkelje të nenit 451 paragrafit 1 në lidhje me nenin 402 par. 1 pikën 4 dhe nenin 406 të KPRK-së. Asnjëra nga dy gjykatat nuk kanë arritur t'i vlerësojnë saktë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese me rastin e llogaritjes së dënimit. Gjykatat i kanë dhënë tepër peshë rrethanave rënduese, kurse nuk i kanë marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese. Në veçanti, gjykata nuk ishte kompetente për ta shqiptuar dënimin maksimal duke u bazuar në dëmin relativisht modest (16,000 Euro) që i është shkaktuar Fondit Garantues të Kosovës. Sa i përket mos marrjes parasysh të rrethanave lehtësuese, i pandehuri përmend faktin se ishte shërbyes civil dhe gjyqtar, se mbante pozitë të besueshme, moshën e tij, dhe obligimet e tij ndaj familjes dhe fëmijëve të tij, tre prej të cilëve janë studentë. I pandehuri konsideron se shqiptimi i dënimit me kusht ose dënimi minimal i paraparë për atë veprë penale do të ishte i mjaftueshëm.

2. Kërkesat e paraqitura nga i pandehuri L.P. dhe në emër të të pandehurit L.P.

A. Kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Rame Gashi në emër të të pandehurit L.P. më 26 dhjetor 2013

- 17) Avokati mbrojtës propozon që kërkesa të pranohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara duke e liruar të pandehurin nga të gjitha akuzat ose përndryshe, të anulohen aktgjykimet e përmendura dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore të Pejës.
- 18) Avokati mbrojtës e bazon kërkesën e tij në baza të nenit 432 nën-paragrafit 1.1. (në shkelje të ligjit penal), 1.2. (në shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale) dhe 1.3. (në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale që ndikojnë në ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara) të KPP-së. Ai i referohet edhe dispozitave të nenit 432 në lidhje me nenin 393 dhe 394 paragrafin 1 nën-paragrafin 1.4 dhe të nenit 35 të KPP-së si dhe shkeljeve të të gjitha bazave në përputhje me nenin 403 paragrafin 1 pikën 10 dhe 12 dhe nenin 404 të KPPK-së.

Në veçanti pretendon se:

- 19) Dispozitivi i aktgjyimit të Gjykatës së Apelit lidhur me të pandehurin K.P. për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme vendimeve gjyqësore në kundërshtim të nenit 346 të KPK-së, është i pakuptueshëm dhe në kundërthënie me arsyetimin si dhe me shkresat dhe me provat e lëndës. Dispozitivi përmend veprimet inkriminuese për të pandehurin L.P., për të cilat as nuk është akuzuar e as nuk është shpallur fajtor. Po ashtu, dispozitivi përmend dashjen e L.P. për të përfituar materialisht për veten e tij gjersa në arsyetim është nxjerrë përfundimi se ia kishte dhënë paratë si kompensim të pandehurit K.P.A. Dispozitivi përshkruan se L.P. më 25 prill (2008) ia ka dhënë K.P.ËS 16,000 Euro kurse gjatë shqyrtimit gjyqësor është dëshmuar se L.P. ka marrë kompensim vetëm për shpenzimet e procedurës, të cilat i takonin.
- 20) Aktgjykimet e kundërshtuara tejkalojnë akuzat pasi aktakuza nuk përmban asnjë propozim për dënim plotësues. Të dy aktgjykimet shqiptojnë ndalesën e ushtrimit të profesionit si dënim plotësues kurse me aktakuzë nuk është kërkuar një dënim i tillë.

- 21) Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Apelit bën shkelje të të drejtave të mbrojtjes në dy pika: Gjykata as nuk ka bërë vlerësimin e as nuk i ka marrë parasysh provat relevante të cilat mbrojtja i ka siguruar me kohë (detajet në faqe 3 par. 5 të kërkesës) edhe pse ishte e obliguar ta bënte këtë.
Po ashtu, aktgjykimi nuk shqyrton dhe nuk merr parasysh ankesën e paraqitur nga vetë i pandehuri L.P. dhe njëkohësisht nuk arrin të japë asnjë përgjigje për argumentet e parashtruara në ankesën e veçantë të avokatit mbrojtës të L.P..
- 22) Veprimi për të cilin i pandehuri L.P. është ndjekur penalisht nuk është vepër penale: I pandehuri nuk ka mundur të kryejë veprën penale të mashtrimit pasi që nuk e ka njohur personalisht F.G. kurse personi i përmendur ishte shok i të pandehurit K.P.. Ai ka vepruar vetëm duke i besuar garancisë së K.P.. Nuk kishte njohuri fare për dokumentet që K.P. i kishte falsifikuar më herët. K.P. kishte idenë për ta paguar shumën e kompensimit në llogari të L.P.. Atë e kishte manipuluar gjyqtari K.P., gjë që është vërtetuar me faktin se nuk kishte pranuar më tepër se shumën e kompensimit të tij për përfaqësimin e klientit, e cila i ka takuar. Rrjedhimisht, ka vepruar pa *mens rea* që kërkohet për veprën penale. Asnjëherë nuk e ka çorientuar kompaninë e sigurimit pasi që ai vetëm ka vepruar para gjykatës.
- 23) Ndarja e akuzave në “më shumë se dy apo tri” lëndë dhe caktimi i tyre te gjykatat me kompetenca të ndryshme përbën shkelje të të drejtave të të pandehurve (parimi i përqendrimit).
- 24) Dispozitivët e të dy aktgjykimeve të kundërshtuara janë në kundërtënie me deklaratat e dhëna nga dëshmitarët F.G. dhe P.J.. Sipas deklaratave të dëshmitarit F.G., i pandehuri L.P. e kishte pyetur dëshmitarin a e i ka marrë paratë e kompensimit dhe dëshmitari kishte thënë se paratë i kishte marrë i pandehuri K.P. si gjyqtar i çështjes. Gjykata e Apelit ka bërë shkelje esenciale të procedurës penale kur ka mohuar se kundërtënie e përmendura e kanë justifikuar anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Dëshmitari P.J. ka konfirmuar se i pandehuri L.P. ia ka treguar F.G.t tërë historinë e ngjarjes pasi ka kuptuar se nuk e ka marrë pagesën e dëmshpërblimit.
- 25) Përveç kësaj, kërkesa përfshin edhe disa pretendime shtesë lidhur me gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Apelit.

B. Kërkesa e paraqitur nga i pandehuri L.P. më 6 janar 2014

- 26) I pandehuri propozon që kërkesa të pranohet si e bazuar, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe të lirohet i pandehuri nga të gjitha akuzat ose përndryshe, të anulohen aktgjykimet e përmendura dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore të Pejës. Në përputhje me nenin 435 paragrafin 4 të KPK-së, ai kërkon që ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë të pezullohet ose të ndërpritet deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Supreme mbi kërkesën e tanishme.
- 27) I pandehuri e bazon kërkesën e tij në baza të nenit 432 nën-paragrafit 1.1. (në shkelje të ligjit penal), 1.2. (në shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale) dhe 1.3. (në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale që ndikojnë në ligjshmërinë e vendimeve të kundërshtuara) të KPP-së. Ai i referohet edhe dispozitave të nenit 432 në lidhje me nenin 393 dhe 394 paragrafin 1 nën-paragrafin 1.4 dhe të nenit 35 të KPP-së si dhe shkeljeve të

të gjitha bazave në përputhje me nenin 403 paragrafin 1 pikën 10 dhe 12 dhe nenin 404 të KPPK-së. Dispozitivi i aktgjykimit të formës së prerë kundër të pandehurit L.P. është në kundërthënie të thellë me arsyetimin e vet si dhe me deklaratat e dëshmitarit dhe me të gjitha provat materiale.

Në veçanti pretendon se:

- 28) Dispozitivi i aktgjykimit të formës së prerë kundër të pandehurit L.P. është në kundërthënie të thellë me arsyetimin e vet si dhe me deklaratat e dëshmitarit dhe me të gjitha provat materiale. Dispozitivi është në kundërthënie me arsyetimin sa i përket asaj se kush kishte propozuar ofertën për marrëveshjen e padisë për shumën e 16,000 Eurove të paguara si kompensim. Trupi gjykues kishte vërtetuar se përfaqësuesi i Fondit Garantues të Kosovës kishte propozuar marrëveshjen. Kjo kundërthënie nuk mund të konsiderohet si e rëndësishme së vogël siç ka vepruar Gjykata e Apelit.
- 29) Me kërkesë pretendohet në shkelje të parimit *ne bis in idem* të përcaktuar me nenin 4 të KPP-së. I pandehuri pretendohet se ishte liruar nga Gjykata Themelore e Prishtinës në lëndën P. Nr. 13/2012 për të njëjtën vepër penale që i nënshtrohet procedurës së tanishme penale. I pandehuri parashtroi se Gjykata e Apelit nuk i ka shqyrtuar provat e reja të cilat i kishte paraqitur bashkë me ankesën e tij kundër aktgjykimit të shkallës së parë.
- 30) Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale të mashtrimit. Nuk i ka vlerësuar në aktgjykim elementet subjektive të veprës penale të mashtrimit në mënyrë eksplicite dhe të hollësishme. I pandehuri L.P. ka vepruar pa dashje; vetë atë e ka mashtruar K.P.. I pandehuri nuk kishte për qëllim përfitimin material për vetvete. Ai ka fituar vetëm 800 Euro, prej të cilave 450 Euro ishte tarifa e ligjshme e avokatit të tij dhe 350 Eurot e mbetura ishin shpenzimet e paguara për ekspertët. Kolegji e konsideroi shumën e njëjtë prej 200 Eurosh si përfitim material për të pandehurit L.P. dhe B.B. pa e vërejtur se ishin pjesë e kompensimit prej 800 Eurove për shpenzimet e procedurës. Nuk ishte menduar e as nuk ishte realizuar asnjë përfitim i paligjshëm për vete. Gjykata e Apelit ka vërtetuar gabimisht ekzistencën e kushtit të kërkuar *mens rea*. *Dolus specialis* ishte vërtetuar vetëm nga Gjykata e Apelit sa i përket të pandehurit K.P..
- I pandehuri L.P. nuk kishte kryer asnjë veprim mashtrues. Ai nuk kishte asnjë rol në emërimin e B.B. si ekspert mjekësor, si dhe nuk ishte ai që i kishte thënë këtij personi se nuk kishte nevojë të ekzaminohet F.G. por K.P..
- Përgjegjësia penale është përjashtuar sepse i pandehuri L.P. ka përfaqësuar palën e dëmtuar në padinë për kompensim (F.G.) duke u bazuar në vendimin e gjyqtarit, edhe pse në shkresë të lëndës nuk kishte autorizim nga klienti. Kolegji i Apelit nuk i ka marrë parasysh fare rrethanat shfajësuese dhe parimin '*in dubio pro reo*'.
- 31) Gjykata e Qarkut nuk ka marrë në pyetje dëshmitarin Z.G., siç ka kërkuar mbrojtja, edhe pse neni 163 paragrafi 3 i KPPK-së parasheh që dëshmitari mund të merret në pyetje jashtë gjykatës.
- 32) Policia dhe prokurori kanë zgjatur hetimet më shumë se një vjet dhe më pastaj e kanë ndarë lëndën në disa aktakuza, edhe pse është dashur të përqendrohej në një lëndë të vetme. I pandehuri pretendon se të drejtat e tij janë cenuar me këto rrethana procedurale.

- 33) Dënimi i shqiptuar kundër të pandehurit L.P. nuk është i bazuar në ligj dhe përbën shkel të drejtat e të pandehurit:
- Dënimi nuk është në përpjesëtim me veprën penale dhe me nivelin e përgjegjësisë penale, në veçanti kur krahasohet me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit B.B..
 - Aktgjykimi nuk i përmend rrethanat lehtësuese dhe rënduese të marra parasysh.
 - Qëllimi i “dërgimit të një sinjali të fuqishëm jo vetëm për kryerësit por edhe për shoqërinë e Kosovës”, i cili është përmendur në arsyetimin e aktgjykimit, nuk është legjitim për llogaritjen e sanksioneve penale.
 - Aktgjykimi nuk ka llogaritur 1 muaj që i pandehuri e ka kaluar në arrest shtëpiak.
 - Heqja e dënimit plotësues ndaj të pandehurit K.P. është shkelje e parimit se të gjithë janë të barabartë para ligjit.
 - Në llogaritjen e dënimit plotësues Gjykata duhet ta konsiderojë faktin se, me kërkesë të prokurorisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës prej vitit 2011 ka pezulluar licencën e të pandehurit për ushtrimin e veprimtarisë së avokatit.
- 34) Gjetjet faktike të gjykatës së shkallës së parë dhe të Gjykatës së Apelit në shumë pjesë janë në kundërtënie me provat. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk i sqaron hollësitë e planit që K.P. kishte përgatitur bashkë me L.P.. L.P. nuk e dinte se F.G. vetëm ishte lënduar lehtë.
- 35) Përveç kësaj, i pandehuri ka paraqitur katër kërkesa për shqyrtimin e provave shtesë, të datave 25 shkurt, 28 prill, 18 qershor dhe 10 korrik 2014, si plotësim i kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Ai gjithashtu ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e shqyrtimit të kërkesës së tij, të datës 15 korrik 2014.

3. Kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi në emër të të pandehurit B.B. më 14 janar 2014

- 36) I pandehuri propozon që kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë të pranohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe i pandehuri të lirohet nga të gjitha akuzat, ose përndryshe, të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet për rigjykim. Mbrojtja e bazon kërkesën kundër të dy aktgjykimeve në shkelje esenciale të Kodit të Procedurës Penale dhe në shkelje të ligjit penal.

Në veçanti i pandehuri pretendon se:

- 37) I pandehuri B.B. është akuzuar vetëm për veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 2 të KPK-së. Përcaktimi i kësaj vepre penale përshekruan vetëm pjesëmarrjen aktive në grup të organizuar kriminal por nuk përshekruan kryerjen reale të asnjë vepre penale. Gjykata nuk ishte e autorizuar të ri-klasifikojë veprën penale të mashtrimit pasi që në aktvendimin për konfirmimin e aktakuzës të Gjykatës së Qarkut në Pejë KA. Nr. 304/2011, të datës 23 shtator 2011, është lejuar vetëm akuza në përputhje me nenin 274 paragrafin 2 të KPK-së.
- 38) E njëjta vlen edhe për ndalesën e të pandehuri për ushtrimin e profesionit, aktiviteteteve ose detyrës si dënim plotësues, në përputhje me nenin 54 paragrafin 1 dhe 2 pikën 4 dhe nenin 57 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së. Aktakuza nuk përmban asnjë propozim për dënim plotësues. Këto shkelje janë konfirmuar dhe vazhduar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

- 39) Aktgjykimi i shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe dispozitivi është në kundërshtim me bazat dhe me arsyetimin. I pandehuri nuk e ka kryer veprën penale të mashtrimit.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk i përshkruan mjaftueshëm elementet e veprës penale të mashtrimit, siç pretendohet se është kryer nga i pandehuri, as elementet objektive e as ato subjektive. Në veçanti, mungon elementi i dashjes (së drejtpërdrejtë) siç kërkon ligji. Vetë Gjykata e Apelit kishte dyshime lidhur me ekzistimin e elementit subjektiv të veprës penale të mashtrimit sa i përket të pandehurit B.B..

Kur përshkruhet mënyra se si i pandehuri B.B. e ka kryer veprën penale të mashtrimit, dispozitivi përmend se ai ka zmadhuar lëndimet që ai “beson” se” i ka pësuar F.G.. I pandehuri i ka besuar autenticitetit të fletë lëshimit të spitalit. Siç ka konfirmuar dëshmitari Dr. M.J. gjatë shqyrtimit gjyqësor, për të ishte e arsyeshme ta bënte këtë, duke u bazuar në cilësinë e raportit (Shih aktgjykimin, faqe 49, par. 2, me titull ‘B.B.’). Ai fare nuk e kishte njohur F.G. e as nuk kishte kontaktuar personalisht ndonjëherë me të. Pasi që aktgjykimi arrin në përfundim se ai mund ti besonte fletë lëshimit të përmendur, ai nuk ka mundur të vepronte me dashje me qëllim të përfitimit material nga z. F.G.. Ai besonte se F.G. në fakti i kishte pësuar lëndimet e përshkruara.

Të dy instancat kanë konstatuar se i pandehuri B.B. nuk ka bërë shkelje të ligjit kur ka dhënë mendimin e tij si ekspert. Të dy gjykatat përfunduan se i pandehuri nuk ka ditur për planin e sajuar nga të pandehurit K.P. dhe L.P. për ta dëmtuar Fondin Garantues të Kosovës dhe se nuk ka marrë më shumë se 200 Euro kompensim për përpilimin e mendimit të ekspertit (shih faqe 7, par. 1.12 i kërkesës; më tutje i pa vërtetuar). Edhe këto elemente objektive të veprës penale mungojnë.

- 40) Gjykata e Apelit, me të gjetur shkeljet nga neni 403 paragrafi 1 pika 12 e KPPK-së, ishte e obliguar që në përputhje me nenin 424 par. 1 të KPPK-së ta anulojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta kthejë në rigjykim. Qëndrimi i Gjykatës së Apelit se “lëshimet e vogla në dispozitiv nuk e arsyetojnë anulimin e aktgjykimit...” është në kundërshtim me formulimin e dispozitave të procedurës penale. Në nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së qartë thuhet se çdo kundërshtim, mospërputhje ose pjesë e pakuptueshme konsiderohet shkelje *esenciale* dhe arsye absolute për anulimin e vendimit përkatës.

- 41) Në parashtresën shtesë, të paraqitur më 2 tetor 2014 para Gjykatës Supreme, avokati mbrojtës Destan Rukiqi propozon në emër të të pandehurit B.B. që dëshmia e K.P. të konsiderohet si e dëshmitarit në shqyrtim gjyqësor para Gjykatës Themelore të Pejës në lëndën kundër I. S., PKR. Nr. 386/2013, të datës 28 shkurt 2014, kur z. K.P. deklaroi se kishte gënjyer për njerëzit që nuk e kishin merituar dhe për këtë arsye ishte dënues njeriu i pafajshëm z. B.B..

4. Përgjigja e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

- 42) ZPShK-ja në përgjigjen ndaj kërkesave i propozon Gjykatës Supreme ta refuzojë kërkesën e të pandehurit K.P. si të pabazuar, por nuk ka bërë propozim sa i përket tre kërkesave të tjera për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga i pandehuri L.P., avokati i tij mbrojtës dhe nga avokati mbrojtës i të pandehurit B.B..

- 43) Sa i përket ri-cilësimit të veprës penale të kryer nga K.P., ajo pajtohet me arsyetimin e Gjykatës së Apelit. Të gjitha elementet e veprës penale janë vlerësuar dhe është konstatuar se ekzistojnë.
- 44) Gjykata nuk ishte e obliguar t'i bashkojë të tre procedurat e veçanta penale në një lëndë të vetme.
- 45) Sa i përket kërkesës së L.P. dhe avokatit të tij mbrojtës, Gjykata kishte të drejtë, në bazë të vlerësimit të gjykatës, t'i pranojë apo t'i refuzojë provat duke u bazuar në rëndësinë dhe në vlerat provuese të tyre.
- 46) Të dy gjykatat kanë provuar mjaftueshëm lidhur me *mens rea* e të pandehurit B.B.. Elementi i dashjes për t'i zmadhuar lëndimet e F.G. është gjetur me faktin se nuk e ka ekzaminuar peronin në fjalë kur njëkohësisht ka konfirmuar lëndimet e rënda trupore të tij.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

1. Pranueshmëria e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë

- 47) Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura në emër të të pandehurve dhe nga të pandehurit janë paraqitur me kohë dhe janë të pranueshme.
- 48) Sa i përket kërkesave plotësuese të paraqitura nga i pandehuri L.P. më 25 shkurt, 28 prill, 18 qershor dhe 10 korrik 2014 Gjykata Supreme konsideron përmbajtjet e këtyre parashtrësive plotësuese janë sqarime ose plotësime të argumenteve faktike dhe ligjore të paraqitura në kërkesat fillestare. Argumentet dhe faktet e reja të paraqitura përveç atyre në kërkesat fillestare nuk janë marrë parasysh sepse janë paraqitur me vonesë.
- 49) Parashtrësat plotësuese të paraqitura më 2 tetor 2014 nga avokati mbrojtës Destan Rukiqi emër të të pandehurit B.B. është hedhur poshtë si e vonuar. Edhe nëse gjykata do ta pranonte parashtrësën si të paraqitur me kohë deh vetëm si plotësim i argumenteve të parashtruara me kërkesën fillestare për mbrojtje të ligjshmërisë, kjo parashtrësë është e papranueshme pasi që mbështetet vetëm në baza të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 432 paragrafi 2 i KPP-së).

2. Përbërja e kolegjit

- 50) Gjykata Supreme e Kosovës me vendim të shumicës vendos se emërimi i kryetarit të kolegjit³ dhe përbërja e kolegjit⁴ është bazuar në kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it të përcaktuara me ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë⁵ (tash e tutje: LmK).

³ Shih mendimin e ndarë mospajtues të gjyqtarit Vuojolahti mbi këtë çështje, bashkëngjitur aktgjykimit.

⁴ Shih mendimin e ndarë mospajtues të gjyqtarës Lushta mbi këtë çështje, bashkëngjitur aktgjykimit.

⁵ Ligji Nr. 03/L-053, 13 mars 2008, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr. 32, e datës 15 maj 2014.

51) Ligji Nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës (tani e tutje si ‘*Ligji omnibus*’), i miratuar më 23 prill 2014, ka hyrë në fuqi më 30 maj 2014 dhe *inter alia* ka ndryshuar LmK-në. *Ligji omnibus* ngrit çështjen e kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it dhe përbërjen e kolegjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e gjykatës. Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur njëzëri se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura në lëndën konkrete duhet të konsiderohet si “rast në proces” në kuptim të nenit të ri 1.A të LmK-së dhe për këtë arsye gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca në këtë lëndë. Prandaj çështja e mbetur ka të bëjë vetëm me atë a është kolegji në përbërje të duhur se kush duhet të jetë kryetar i kolegjit.

52) Neni 3 i *Ligjit Omnibus* ka shtuar nenin 1.A dhe ka ndryshuar nenin 3 të *Ligjit mbi kompetencat* si në vijim:

Neni 1.A.
Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji rast në proces nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin.

2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

Neni 3.

Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it për procedurat penale

3.1. . Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurat penale do të kenë juridiksion dhe kompetenca për rastet që janë në proces siç përcaktohet në nenin 2.2 të këtij ligji.

3.2. ...

3.3. Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtar vendorë. Me kërkesën e bazuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

3.4. ...

53) Neni i ndryshuar 2.3 i LmK-së përcakton se Sipas nevojës, aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore:

“...do të përcaktohen me tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shefit të EULEX KOSOVA dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës”

- 54) Më 18 qershor 2014, është arritur një marrëveshje në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore (tani e tutje ‘Marrëveshja’).
- 55) Relevante për pyetjen se kush duhet të veprojë si kryetar i kolegjit është çështja nëse rasti duhet të konsiderohet si rast “në proces”.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik që përdoret kundër vendimeve të formës së prerë. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet rast në pritje kur paraqitet në gjykatë. Kjo mbështet interpretimin se ky rast i mjetit të jashtëzakonshëm juridik më 15 prill 2014 nuk ka qenë rast në proces dhe prandaj do të ishte jashtë kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it.

Në anën tjetër, çështja thelbësore është se si do të interpretohet fjalia ‘Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prillit 2014’ në situatën kur ‘rasti’ i referohet kërkesave për mjete të jashtëzakonshme juridike.

Kolegji vëren se LmK është ndryshuar nga autoriteti kompetent i Kosovës pas një marrëveshje ndërkombëtare të arritur me shkëmbimin e letrave në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (për misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, tani e tutje Marrëveshja Ndërkombëtare), të ratifikuar me Ligjin nr. 04/L-274. Marrëveshja Ndërkombëtare në lidhje të drejtpërdrejtë me Ligjin mbi kompetencat përcakton se tranzicionin i mandatit të EULEX-it në Kosovë bazohet në politikën ‘normalisht jo më raste të reja’. Kjo jep arsye për të përfunduar se marrëveshja ndërkombëtare është bazuar në idenë se rastet me të cilat kanë qenë duke u marrë prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it (para 15 prillit 2014) gjithashtu duhet të përfundohen nën kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it.

Neni i ri 1.A i Ligjit mbi kompetencat flet për ‘rastet’. Ligji nuk jep asnjë sqarim të mëtutjeshëm se çka nënkupton ky koncept i ‘rastit’. Sidoqoftë, është mjaft e qartë se ‘rasti’ i referohet procedurës penale që ka të bëjë me një apo më tepër vepra penale. Neni 68 i Kodit të Procedurës Penale (KPP-së) sqaron fazat e procedurës penale si në vijim:

“Sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik”.

Hetimi penal fillohet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale (apo do të kryhet). Vendimi për fillimin e hetimit specifikon *inter alia* të dyshuarin, përshkrimin e aktit duke specifikuar elementet e veprës penale, dhe cilësimin juridik të veprës penale. Më vonë, është e mundur që hetimi të zgjerohet. Sidoqoftë, kur hetimi të ketë përfunduar sipas kushteve të përcaktuara me ligj, ‘rasti’ shkon në fazën e ardhshme (faza e aktakuzës dhe deklarimit), pastaj në shqyrtim gjyqësor dhe në fund në fazën e mjetit juridik. Por gjatë gjithë këtyre fazave të përmendura më lart, ‘rasti’ është i njëjti: ka të bëjë me të njëjtat fakte relevante të cilat përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri është dyshuar, apo për të cilën është akuzuar, apo për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar.

Titulli i Kapitullit XXI në KPP është “Mjetet juridike”. Kapitulli përfshin mjetet e zakonshme juridike dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Kolegji konsideron se koncepti i ‘rastit’ në nenin 1.A të LmK-së patjetër duhet të interpretohet në atë mënyrë që të përfshinë të gjitha fazat e procedurës penale, përfshirë mjetet e jashtëzakonshme juridike. ‘Rasti’ ka të bëjmë me të njëjtin të pandehur, të njëjtën veprë penale dhe të njëjtat fakte, p.sh. të njëjtat merita. Ai nuk bëhet rast i ri vetëm pse hyn në një fazë të re të procedurës penale.

Ligji Omnibus bazohet në Traktatin Ndërkombëtar; Ligji omnibus zbaton atë për çfarë janë pajtuar në Traktatin Ndërkombëtar. Për këtë arsye konsideroj se gjatë interpretimit të dispozitave të reja të Ligjit mbi kompetencat vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet nenit 3 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (tani e tutje *Konventa e Vjenës*). Kjo konventë është ligj i aplikueshëm gjithashtu edhe në Kosovë. Neni 31 i Konventës së Vjenës përcakton rregullat për interpretimin e traktateve. Neni 31 përcakton:

“ 1. Një traktat do të interpretohet në mirëbesim në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u jepet termave të traktatit në kontekstin e tyre dhe në dritën e objektit dhe qëllimit të tij.

2. Konteksti për qëllimin e interpretimit të një traktati do të përmbajë përveç tekstit edhe preambulën dhe shtojcat:

(a) çdo marrëveshje e lidhur me traktatin e cila ishte bërë midis të gjitha palëve në lidhje me përfundimin e traktatit;

...

3. Do të merren parasysh, së bashku me kontekstin:

(a) çdo marrëveshje e mëtejshme midis palëve që ka lidhje me interpretimin e një traktati apo zbatimin e dispozitave të tij;”

Formulimi i nenit 3 të Ligjit mbi kompetencat mbështet interpretimin se shumica e kolegjit duhet të përbëhet nga gjyqtarët vendor. Sidoqoftë, Pika 2 e *Marrëveshjes* thekson se, *në të gjitha rastet në proces trupat gjykues të përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it në kolegje për vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit dhe pjesën e mbetur të procedurës*

Në bazë të nenit 31.3 të Konventës së Vjenës, Marrëveshja e arritur në mes të palëve të njëjta duhet të merret parasysh gjatë interpretimit të dispozitave të reja të *Ligjit mbi kompetencat*.

Formulimi i pikës 2 të *Marrëveshjes* është i paqartë. Në njërën anë, flet për *trupat gjykues*, që mund të konsiderohet se i referohen vetëm gjykimit në shkallë të parë. Në anën tjetër flet për *‘të gjitha fazat e gjykimit dhe pjesën e mbetur të procedurës’*, që në mënyrë të qartë drejton në të gjitha fazat e gjykimit dhe *procedurës*. Kur *Marrëveshja* është dashur të jap udhëzime (‘s qarime të mëtutjeshme’) për interpretimin e Ligjit omnibus, është e drejtë të supozohet se do të shprehte në mënyrë të qartë, duke përdorë koncepte të sakta juridike, qëllimin dhe fushëveprimin e kësaj dispozite.

Kolegji konsideron se duke e përsëritur dy herë çështjen e njëjtë duke përdorë shprehje të ndryshme (‘*në vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit dhe pjesën e mbetur të procedurës*’), palët e *Marrëveshjes* kanë theksuar se dispozita ka të bëjë me të gjitha fazat e procedurës penale. Kjo do të thotë se dispozita gjithashtu përfshin edhe fazën e mjeteve juridike. Për më tepër, formulimi i Pikës 2 të *Marrëveshjes* në mënyrë të qartë i referohet

'vazhdimet' me përbërjen e kolegjit kur thekson se '... në të gjitha rastet në proces trupat gjykues në përbërje me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe do të vazhdojnë me shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it'. Ky formulim tregon se qëllimi ka qenë që të ruhet gjendja e mëparshme gjithashtu edhe sa i përket çështjes lidhur me përbërjen e kolegjit.

Prandaj, kolegji përfundon se neni 3 i Ligjit mbi kompetencat, përkundër formulimit të tij, duhet të interpretohet në kuptim të qëllimit të Traktatit Ndërkombëtar siç është sqaruar në Marrëveshje. Leximi i përbashkët i nenit 3 të Ligjit mbi kompetencat dhe Pikës 2 të Marrëveshjes shpie në interpretimin se *kur një kolegji ka qenë i përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it apo një gjyqtar i EULEX-it si kryetar i kolegjit, të gjitha fazat vijuese të procedurës gjithashtu mund të zhvillohen me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe me kryetar të kolegjit.* Ky interpretim është gjithashtu në përputhje me politikën "normalisht jo më raste të reja" siç është përkthyer në marrëveshjen ndërkombëtare (paragrafi 8, më lart). Prandaj, procedura në lidhje me gjykimin e një rasti në proces nuk ndikohet nga ndryshimet që kanë hyrë në fuqi që nga 30 maji 2014.

- 56) Të dyja, edhe trupi gjykues gjithashtu edhe kolegji i Gjykatës së Apelit kanë qenë të përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it. Duke zbatuar dispozitat e përmendura më parë, është konstatuar se kolegji është përbërë drejtë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.
- 57) Kryetari i kolegjit në kolegjin aktual është caktuar duke zbatuar nenin 3.3 të Ligjit mbi kompetencat.

3. I pandehuri K.P.

- 58) Gjykata Supreme gjen kërkesën e të pandehurit pjesërisht të bazuar dhe pjesën e mbetur të kërkesës e refuzon si të pabazuar.
- 59) Në kërkesën e të pandehurit pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit duke pranuar se lënda kundër të pandehurit është ndarë në katër lëndë të ndryshme ka bërë shkelje substanciale të procedurës penale, ligjit penal dhe të drejtave të pandehurit, në veçanti nenit 81 të KPRK-së. Lënda është dashur të përqendrohet në një lëndë pasi që janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale në vazhdimësi.
- 60) Kolegji refuzon këtë argument si të pabazuar.

Sa i përket pretendimit të pandehurit se faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor duke përcaktuar natyrën dhe cilësimin juridik të veprës penale janë të gabuara ose jo të plota, Gjykata Supreme i referohet nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së, i cili përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të bazohet në këto arsye.

Sa i përket pretendimit të pandehurit se aktgjykimi i formës së prerë ka dështuar që t'i vlerësojë drejtë faktet e vërtetuara nga trupi gjykues në lidhje me cilësimin juridik, ai nuk ka mbështetur ekzistimin e elementeve të veprës penale në vazhdimësi. Asnjë detaj faktik lidhur me veprat tjera penale të cilat i janë nënshtruar procedurës penale nuk është përmendur nën numrat II deri IV në faqen 3 të kërkesës së tij.

Përveç kësaj, gjykata i referohet nenit 81 paragrafit 4 të KPRK-së. Sipas kësaj dispozite, cilësimi i veprës penale në vazhdimësi madje mund të jetë në dëm të të pandehurit. Duke zbatuar nenin 3 paragrafin 2 të KPRK-së, gjykata është e obliguar që ta zbatojë ligjin më të favorshëm ndaj kryerësit.

- 61) Nuk ka shkelje të të drejtave të pandehurit. Parimi i pranuar përgjithësisht i përqendrimit, i cili i udhëzon gjykatat t'i përqendrojnë veprat penale që lidhen mes veti në një procedurë penale, ka për qëllim ekskluziv që të sigurojë ekonomizimin dhe efikasitetin e procedurës dhe nuk shërben për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit. Nëse ka elemente të tjera që janë në konflikt me qëllimin për ta organizuar procedurës në mënyrën më efikase, si për shembull pengesat procedurale që lidhet me njërin nga disa të pandehur, gjykatat janë të lira që t'i ndajnë lëndët dhe të procedojnë ndaras. Prandaj, i pandehuri nuk mund të pretendojë që devijimin nga parimi si shkelje e të drejtave procedurale të tij. E drejta e tij për të pranuar dënimin e drejtë dhe proporcional është e mbrojtur përmes dispozitës së nenit 82 paragrafit 1 të KPRK-së (më parë KPK neni 72), i cili i obligon gjykatat që në rast të shpalljes fajtor të një personi i cili ka qenë i dënuar më parë t'ia caktoj një dënim unik duke pasur parasysh dënimin e shqiptuar më parë.
- 62) I pandehuri gjithashtu pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë vendime të gabuara mbi sanksionet penale. Gjatë llogaritës së dënimit, të dy gjykatat kanë dështuar që të vlerësojnë drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Duke shqiptuar dënimin maksimal me burgim prej pesë viteve për kryerjen e veprave penale Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, Gjukata e Apelit ka bërë shkelje të ligjit penal.
- 63) Kolegji i Gjukatës Supreme e gjen këtë argument të bazuar. Gjukata e Apelit nuk ka marrë parasysh se gjykata ka vërtetuar ekzistimin e rrethanave lehtësuese, por pavarësisht nga kjo ka shqiptuar dënimin maksimal të zbatueshëm për veprën penale, kështu duke shkelur rregullat e përgjithshme mbi caktimin e dënimeve sipas nenit 64 të KPK-së.
- 64) Së pari, shumica⁶ e kolegjit të Gjukatës Supreme konsideron se sipas nenit 432 nën-paragrafit 1.1 të KPP-së në lidhje me nenin 64 të KPK-së, i pandehuri ka pasur të drejtë që ta bazojë kërkesën e tij në këtë arsye. Shkelja e dispozitës së përmendur të KPK-së përbën shkelje të ligjit penal.

Neni 432 paragrafi 1 i KPP-së numëron arsyet në bazë të të cilave mund të paraqitet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë:

“1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.3. ...”

Fakti se gjersa nën-paragrafi 1.2. i referohet vetëm shkeljeve procedurale të cilat shprehimisht janë përcaktuar me nenin 384 paragrafin 1 të KPP-së, nën-paragrafi 1.1. nuk ka kufizime të tilla, në mënyrë të qartë tregon se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë mund të bazohet në çdo shkelje të ligjit penal. Edhe pse neni 385 i KPP-së i numëron shkeljet e ligjit penal për qëllime të ankesave kundër aktgjyqimeve, neni 432 paragrafi 1.1 i KPP-së nuk i referohet asaj dispozite.

⁶ Shih mendimin e ndarë të Gjyqtarës Lushta të bashkangjitur në këtë aktgjykim.

Prandaj, shkeljet e ligjit penal që mund të pretendohen me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk kufizohen në shkeljet e përcaktuara me nenin 385 të KPP-së.

- 65) Së dyti, sa i përket shkeljes së ligjit penal, shumica e kolegjit të Gjykatës Suprem konstaton si në vijim:
- 66) Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka shpallur fajtor të pandehurin për kryerjen e veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit në shkelje të nenit 339 paragrafëve 1 dhe 3 të KPK-së dhe shqiptuar dënimin prej pesë (5) viteve burgim dhe dënimin plotësues ndalim i ushtrimit të funksioneve publike në administratën publike ose në shërbimin publik për një periudhë tre (3) vjeçare pas vuajtjes së dënimit kryesor. Në faqen 55 nën titullin ‘Zbutja/Rritja e dënimit, Gjykata e Qarkut përmend rrethanat të cilat janë marrë parasysh gjatë llogaritjes së dënimit kundër K.P. si në vijim:

“Ai nuk ka treguar keqardhje. Veprimet e tij kanë shërbyer për ta minuar besimin në administrimin e drejtësisë. Veprimet e tij kanë rezultuar në humbje financiare prej 16,800 Euro të Fondit Garantues të Kosovës. Asnjë provë e dënimeve të mëparshme nuk i është paraqitur gjykatës.”

- 67) Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit ka ri-cilësuar veprën penale si Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në shkelje të nenit 346 të KPK-së dhe ka mbajtur dënimin kryesor të shqiptuar prej pesë (5) viteve burgim. Gjithashtu, është mbështetur edhe dënimi plotësues. Si rrethanë lehtësuese, Gjykata e Apelit ka marrë parasysh faktin se i akuzuari nuk ka pasur dënime të mëparshme (paragrafi 62 në faqe 20). Si rrethanë rënduese, gjykata ka marrë parasysh rrethanat në vijim (ibid.):

“...dëmin e lartë material prej 16,800 Euro...; organizimin specifik të krimit, posaçërisht përfshirjen e personave të tjerë dhe skemën e elaboruar e cila është përdorë për të mashtruar Fondin e Garancisë së Kosovës; pozitën e ndikimit të akuzuarit ndaj të bashkëpandehurit L.P., ish trajner-avokat nën mbikëqyrjen e tij, të cilën i pandehuri K.P. e ka përdorë në dobi të tij.”

Gjykata (në paragrafin 63 në faqe 20) gjithashtu ka marrë parasysh si qëllim të dënimit parandalimin e përgjithshëm dhe individual dhe faktin se Kosova është dëmtuar rëndë nga praktika korruptive në vazhdimësi në mesin e entiteteve shtetërore, përfshirë gjyqësorin. Duhet të dërgohen sinjale të fuqishme te kryerësit dhe te shoqëria e Kosovës duke demonstruar se këto krime do të ndiqen dhe kryerësit do të ballafaqohen me drejtësinë në kuptimin më të fuqishëm.

- 68) Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka marrë parasysh mungesën e keqardhjes dhe rezultatit e minimimit të besimit publik në administrimin e drejtësisë si rrethana rënduese. Keqardhja e treguar nga i pandehuri mund të konsiderohet si faktor lehtësues (shih nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së) por mungesa e saj nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese. Po ashtu, fakti se besimi në administrimin publik është duke u minuar është i pandashëm nga vepra penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339 paragrafët 1 dhe 3 i KPK-së) dhe prandaj nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese plotësuese.

Gjykata e Apelit si duket ka korrigjuar mangësitë në përcaktimin e dënimit duke i cekur saktë të gjitha rrethanat relevante. Sidoqoftë, (në paragrafin 63 në faqe 20) Gjykata e

Apelit përfundon si rezultat i shqyrtimit të ashpërsisë së dënimit "...nevojën për të shqiptuar dënimin maksimal ...".

Gjatë zbatimit të rregullave për llogaritjen e dënimit të përcaktuara me nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së (që korrespondon me nenin 73 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPRK-së) Gjykata e Apelit ka gabuar kur ka shqiptuar dënimin maksimal të lejuar për veprën penale të përshkruar në nenin 346 të KPK-së. Pasi që në aktgjykim është përmendur së paku një rrethanë lehtësuese, logjikisht Gjykata e Apelit nuk është dashur të shqiptojë dënimin maksimal. Duke filluar nga limiti i përcaktuar me ligj në nenin 346 të KPK-së (burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vite) duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, siç është përcaktuar me nenin 64 paragrafin 1 të KPK-së, gjykata është dashur të shqiptojë dënimin diku nën limitin e lartë të nenit 346 të KPK-së. Gjersa ligji përcakton mundësinë që të shqiptohen dënime nën limitin e ulët të përcaktuar me dispozitat përkatëse ligjore, (neni 66 i KPK-së, neni 75 i KPRK-së), limiti i lartë është absolut. Rrjedhimisht, kurdo që identifikohet së paku një rrethanë lehtësuese, patjetër duhet të bëhet një ulje e dënimit nga limiti maksimal.

Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e Apelit ka bërë shkelje të ligjit penal gjatë shqiptimit të dënimit maksimal të aplikueshëm për veprën penale duke nxjerrë vendim gjyqësor të kundërligjshëm. Sipas nenit 438 paragrafit 1 nën-paragrafit 1.1 Gjykata Supreme, duke u pajtuar me të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të përmendura në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ndryshon aktgjykimin dhe përcakton se dënimi prej katër (4) viteve dhe gjashtë (muajve) është proporcional.

4. I pandehuri L.P.

- 69) Kolegji i Gjykatës Supreme refuzon si të pabazuar kërkesën e paraqitur nga i pandehuri L.P. si dhe kërkesën e paraqitur në emër të tij nga avokati i tij mbrojtës.
- 70) Në kërkesën e të pandehurit pretendohet se dispozitivi i të dy aktgjykimeve të kundërshtuara përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal pasi që elementet e veprës penale Mashtrim nuk janë vërtetuar nga Gjykata e Qarkut dhe nuk janë përshkruar në dispozitiv. Ky argument është i pabazuar. Gjykata Supreme është e mendimit se edhe elementet objektive e edhe ato subjektive të veprës penale Mashtrim janë vërtetuar në aktgjykimin e shkallës së parë dhe janë përshkruar në hollësi në dispozitiv. Dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm.

Duke përmendur qëllimin për të përfituar dobi pasurore të kundërligjshme për vetën dhe të bashkëpandehurin K.P., Gjykata e Qarkut ka përshkruar *mens rea* e cila kërkohet me nenin 261 paragrafin 1 të KPK-së. Detajet e planit i cili është përgatitur së bashku nga të pandehurit janë përshkruar në dispozitiv. Plani konsistonte në paraqitjen e kërkesës për kompensim kundër Fondit Garantues të Kosovës pranë gjykatës në emër të F.G. pa njohurinë e personit, zmadhimin e lëndimeve të pësuar nga F.G. që si rezultat kanë përfituar dobi pasurore. Elementet objektive konsistojnë në realizimin e planit të përshkruar me të pandehurit duke e 'përfaqësuar' gjoja palën e dëmtuar F.G. pa autorizimin apo njohurinë e tij në procedurën gjyqësore, duke pranuar shumën e kompensimit, përfshirë shpenzimet e procedurës gjyqësore si dhe kompensimin e tij si avokat për 'përfaqësimin' e paditësit, të paguar nga Fondi Garantues i Kosovës dhe duke ia dhënë K.P. shumën prej 16,000 Euro.

- 71) Nuk ka kundërthënie të brendshme në dispozitivet e asnjërit aktgjykim të shkallës së parë e as të atij të Gjykatës së Apelit.

Aktgjykimi i shkallës së parë në dispozitivin dhe në arsyetimin e tij vazhdimisht përshkruan dorëzimin e 16,000 Eurove në para të gatshme nga i pandehuri L.P. te K.P.. Kjo e gjetur e Gjykatës së Qarkut bazohet në deklaratën e vetë të pandehurit L.P. gjatë shqyrtimit gjyqësor (faqe 25, paragrafi 5).

Kundërshtimi se ky dorëzim ka rezultuar në situatën ku i pandehuri më nuk ka asnjë dobi pasurore nga veprimet e tij nuk qëndron. Vepra penale mashtrim madje nuk kërkon as përfitimin e dobisë pasurore të vërtetë por vetëm qëllimin për ta përfituar. Qëllimi madje edhe për të përfituar kompensimin për ‘përfaqësimin e tij ligjor’ të paautorizuar dhe jo-legjitim të F.G. para gjykatës mjafton për t’i përmbushur kushtet e nenit 261 paragrafit 1të KPK-së.

Argumenti i të pandehurit se ai në fakt ligjërisht ka pasur të drejtë në tarifën e avokatit për përfaqësimin e klientit F.G. nuk qëndron. Pasi që i pandehuri asnjëherë nuk është autorizuar për ta përfaqësuar klientin e tij, e as klienti nuk ka pasur njohuri lidhur se ky ‘përfaqësim’ i pretenduar nuk ka qenë përfaqësim ligjor i vërtetë. Mbi të gjitha, i pandehuri asnjëherë nuk ka pasur për qëllim, e as nuk ka vepruar në interes të klientit gjatë ‘përfaqësimit’ të tij në gjykatë.

- 72) I pandehuri ka paraqitur pretendimin se ka mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së parë lidhur me atë se kush ka propozuar zgjedhjen e procedurës gjyqësore në shumë prej 16,000 Eurove. Gjykata e Apelit ka shqyrtuar këtë çështje në paragrafët 18 dhe 19 në faqe 9 të aktgjykimit të saj. Gjykata Supreme pajtohet se çështja nuk lidhet me faktet vendimtare të aktgjykimit dhe se paraqet një gabim të vogël.

Çdo gabim *de minimus* në aktgjykimin e shkallës së parë është korrigjuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Të dy aktgjykimet e kundërshtuara në arsyetimet e tyre kanë përshkruar në detaje veprimet e të pandehurit L.P. në lidhje me negocimin e marrëveshjes për kompensim. Nuk ka asnjë dyshim se ai ka kontribuar në mënyrë aktive në mashtrimin e përfaqësimit të paditësit F.G.. I pandehuri– gjoja në emër të klientit të tij F.G. – kishte refuzuar ofertën e parë për kompensim të propozuar nga përfaqësuesi i Fondit Garantues të Kosovës. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i pandehuri pas ofertës përfundimtare është larguar nga gjykatorja, gjoja për tu konsultuar me klientin e tij. Të dy aktgjykimet e kundërshtuara janë të qarta në përshkrimin e veprimeve të pandehurit në negocimin e shumës së kompensimit. Është e parëndësishme se kush në të vërtetë e ka propozuar ofertën përfundimtare pasi që është bërë në marrëveshje të përbashkët në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të Fondit Garantues të Kosovës dhe shuma e parave është caktuar deri në masë të madhe nga negocimi paraprak i të pandehurit dhe nga refuzimi i tij i ofertës së parë. Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se arsyetimi i paraqitur nga gjykata nuk është në kundërthënie me gjetjet e vërtetuara në dispozitiv.

- 73) I pandehuri pohon se dispozitivi i aktgjykimi i formës së prerë në lidhje me të pandehurin K.P. për veprën penale Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore sipas nenit 346 të KPK-së është e pakuptueshme dhe në kundërthënie me arsyetimin si dhe me procesverbalin e provave të lëndës sepse përmend akte inkriminuese për të pandehurin L.P., për të cilat ai as nuk është akuzuar e as nuk është shpallur fajtor. Kolegji gjen se ky

pretendim është i pabazë dhe i referohet argumenteve në lidhje me dorëzimin e 16,000 Eurove më lart. Dorëzimi nuk e eliminon qëllimin e të pandehurit për të përfutur dobi pasurore. Dispozitivi në mënyrë të qartë shtjellon se qëllimi i K.P. ka qenë që të përfutoj dobi pasurore për “vetveten” duke iu referuar të dy të pandehurve K.P. dhe L.P.. Nuk ka asnjë kundërtënie në mes të dispozitivit dhe arsyesimit. Korrespondon me të gjitha të gjeturat e gjykatave të të dy shkallëve në lidhje me veprën penale për të cilën L.P. është shpallur fajtor.

74) Gjykata Supreme refuzon pretendimin se përgjegjësia penale e të pandehurit është përjashtuar për shkak se i pandehuri L.P. ka përfaqësuar palën e dëmtuar në lëndën e kërkesës për kompensim (F.G.) në bazë të vendimit të gjyqtarit, edhe pse në shkresat e lëndës nuk ka pasur autorizim nga klienti. Gjyqtari nuk mund të urdhërojë avokatin që ta përfaqësoj një klient në procedurë civile pa dijeninë dhe autorizimin e klientit.

75) I pandehuri gjithashtu ka paraqitur pretendimin se edhe ai vete kishte qenë i mashtruar dhe i shfrytëzuar nga i bashkëpandehuri K.P.. Të dy shkallët e mëparshme kanë pranuar ndikimin që Gjyqtari K.P. ka pasur ndaj ish praktikantit të tij dhe e ka marrë parasysh gjatë vlerësimit të përgjegjësisë penale. Ajo vetëm mund ta arsyetojë zbutjen e asaj përgjegjësie por nuk mund të shërbejë si shfajësim. L.P., edhe pse akoma relativisht i ri, ka pasur diplomë të juridikut dhe pak përvojë në punën si avokat dhe ka qenë në dijeni për obligimin e tij në drejtim të klientit potencial, kushtet ligjore lidhur me të vërtetën para gjykatës si dhe pasojat e mundshme të veprimeve në kundërshtim me ligjin.

76) I pandehuri pretendon se të drejtat e tij janë dëmtuar nga dështimi i Gjykatës së Qarkut për të dëgjuar dëshmitarin Z.G.. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë duke iu referuar dëshmitarit të përmendur në faqen 20 vetëm thekson se gjykata ka ftuar dëshmitarin e propozuar Z.G. për të dhënë dëshmi, por ishte njoftuar nga familja e tij se ai ishte 80 vjeçar dhe me gjendje shëndetësore të dobët. Kolegji pranon se trupi gjykues nuk ka sqaruar mjaftueshëm arsyet se pse nuk ka ekzaminuar dëshmitarin e propozuar nga mbrojtja jashtë gjykatës, nëse dëshmitari nuk ka qenë në gjendje të të marrë pjesë në seancën e gjykatës, siç është përcaktuar me nenin 163 paragrafin 3 të KPPK-së.

Sidoqoftë, i pandehuri në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dështon që të mbështes se si dëshmia e dëshmitarit do të ndikonte në rezultatin e procedurës penale. Dëshmitari P.J. është dëgjuar lidhur me bisedën të cilën i pandehuri e ka pasur më 2010 me F.G. dhe dëshmia e tij është gjetur e besueshme dhe është vërtetuar nga dëshmia e F.G. dhe pjesërisht nga vetë dëshmia e të pandehurit. Prandaj, kolegji konstaton se të drejtat e pandehurit nuk janë ndikuar nga mangësitë e adresuara.

77) Kolegji gjen se kundërshtimi i të pandehurit se Gjykata e Apelit ka dështuar që të marrë parasysh ankesën e paraqitur nga vetë i pandehuri është pa merita. Gjykata i referohet faqes 2, paragrafëve 18, 19 dhe disa paragrafëve të tjerë ku shprehimisht i referohen ankesës së të pandehurit dhe argumenteve të paraqitura me këtë ankesë.

78) Pretendimi se Kolegji i apelit nuk ka marrë parasysh rrethanat shfajësuese si dhe parimin ‘*in dubio pro reo*’ është pa substancë. I pandehuri nuk ka shtjelluar pretendimin e tij në hollësi. Gjykata e shkallës së dytë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante të nevojshme për përcaktimin e përgjegjësisë penale të të pandehurit.

79) I pandehuri ka pretenduar në shkëlqje të parimit *ne bis in idem* të përcaktuar në nenin 4 të KPP-së. Ai gjoja ishte liruar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë në një lëndë tjetër penale

P. Nr. 13/2012 për të njëjtën vepër penale e cila është objekt i procedurës aktuale. I pandehuri parashtron se Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar provat e reja në lidhje me këtë argument, provat të cilat ai i kishte dorëzuar së bashku me ankesën e tij kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të kujdesshëm të dokumenteve të pandehurit të dorëzuara së bashku me ankesën e tij kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe procesverbalit të seancës publike pranë Gjykatës së Apelit të 25 prillit 2013, gjen këtë pretendim të pabazuar.

Neni 4 paragrafi 1 i KPP-së përcakton se askush nuk mund të ndiqet penalisht apo të dënohet për një vepër penale, nëse ai apo ajo është liruar apo dënuar për atë me vendim të gjykatës të formës së prerë. Gjersa ky parim duhet të respektohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare, kolegji nuk ka gjetur asnjë indikacion për ekzistimin e një vendimi të formës së prerë për veprën e njëjtë penale.

Pretendimi i të pandehurit se ka dorëzuar prova në lidhje me shkeljen e parimit *ne bis in idem* në Gjykatën e Apelit është pa substancë. Shkresat e lëndës nuk përmbajnë dokumente të tilla; ankesa e të pandehurit si duket është paraqitur pa asnjë provë të bashkangjitur. Procesverbali i seancës publike nuk përmban asnjë shënim se i pandehuri apo avokati i tij mbrojtës kanë propozuar apo dorëzuar prova apo dokumente shtesë.

- 80) Në kërkesë pretendohet se hetimi është zvarritur për më shumë se një vit dhe pastaj rasti është ndarë në disa aktakuza, edhe pse është dashur të përqendrohet në një gjykim; kjo ka dëmtuar të drejtat e të pandehurit.

Gjykata gjen këtë argument të pa meritë dhe i referohet paragrafit 62 më lart (faqe 16) në lidhje me praktikën procedurale të përqendrimit. I pandehuri nuk mund të pretendoj se devijimi nga parimi i përqendrimit është shkelje e të drejtave procedurale të tij. Gjykatat janë të lira që të ndajnë apo bashkojnë rastet në bazë të nevojave procedurale, siç diktohen nga qëllimi i organizimit të procedurës në mënyrë më efektive.

Zvarritja e tepërt e pretenduar e hetimit nuk është mbështetur nga i pandehuri. Ai nuk ka elaboruar se si kohëzgjatja e hetimit ka shkelur dispozitat e procedurës penale.

- 81) Në kërkesë pretendohet se aktgjykimi i formës së prerë nuk ka llogaritur se i pandehuri ka kaluar 1 muaj në arrest shtëpiak. Gjykata nuk ka gjetur asnjë shënim në shkresat e lëndës në mbështetje të pretendimit se arresti shtëpiak është caktuar kundër tij në procedurën penale aktuale. Prandaj, pretendimi patjetër duhet të refuzohet.

Në rast se i pandehuri me të vërtetë ka kaluar kohë në arrest shtëpiak i cili është caktuar në procedurën penale aktuale, ai ka mundësi që të kërkojë llogaritjen e asaj kohe në procedurën e ekzekutimit në bazë të nenit 489 paragrafit 1 të KPP-së.

- 82) Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në proporcion me përgjegjësinë e tij penale, peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit, sipas nenit 64 paragrafit 1 të KPK-së.

Pretendimi se aktgjykimi i formës së prerë nuk përmend rrethanat lehtësuese dhe rënduese është pa substancë. Gjykata i referohet paragrafit 54 (faqe 19) të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe kapitullit të titulluar “L.P.” në faqe 55 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

Lidhur me qëllimin e dënimit, kolegji i referohet nenit 64 paragrafit 1 në lidhje me nenin 34 të KPK-së (që korrespondon me nenin 73 paragrafin 1 në lidhje me nenin 41 të KPRK-së). Parandalimi i përgjithshëm është njëri nga qëllimet e dënimit për secilin kryerës, siç është përcaktuar me ligj.

Pretendimi i të pandehurit se në krahasim me dënimet e tjera, dënimi i tij është i padrejtë dhe shkel parimin e barazisë para ligjit, nuk është bindës. Dënimet caktohet kundër secilit të pandehur individualisht dhe duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat specifike në lidhje me veprën specifike dhe personin specifik. Prandaj, krahasimi i drejtpërdrejtë me dënimet tjera të shqiptuara për veprat e ngjashme penale në lëndë tjera nuk është i mundur. Parimi i barazisë para ligjit dikton që faktet e ngjashme apo të barabarta do të trajtohen ngjashëm apo në mënyrë të barabartë. Lidhur me kushtet relevante për llogaritjen e dënimeve, kushteve dhe rrethanave gati asnjëherë nuk janë të njëjta për dy kryerës të ndryshëm apo për dy vepra penale të ndryshme.

Gjykata nuk mund t'i përmbahet propozimit për llogaritjen e kohës gjatë të cilës licenca e tij për të ushtruar veprimtarinë e avokatit është suspenduar nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Kjo masë nuk ka qenë e lidhur me dënimin për veprën penale por një masë administrative për ta mbrojtur publikun.

- 83) I pandehuri ka paraqitur disa argumente të cilat nuk mund të cilësohen si shkelje të ligjit të procedurës penale apo të ligjit penal. Këtu, kolegji i referohet të gjitha pretendimeve në lidhje me vlerësimin e provave nga gjykata. Këto argumente hedhen poshtë si të pretendime të papranueshme të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së. Neni 439 i KPP-së nuk është i zbatueshëm këtu pasi që nuk është gjetur “dyshim i konsiderueshëm për vërtetimin faktik” të vendimeve të kundërshtuara.
- 84) Në kërkesën e tij plotësuese e paraqitur më 10 korrik 2014, i pandehuri pretendon se parashkrimi kishte skaduar kur ishte ngritur aktakuza. Edhe pse argumentet e paraqitura në këtë kërkesë janë të paafatshme (shih paragrafin 48 në faqe 11 më lart), gjykata sipas detyrës zyrtare është dashur të shqyrtojë nëse prokuroria është e bllokuar për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit. Neni 90 paragrafi 1 pika 4 e KPK-së rregullon parashkrimin për veprën penale Mashtrim, sipas nenit 261 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së, për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Sipas nenit 261 paragrafit 2 të KPK-së, kufiri i sipërm i kornizës së dënimit prej pesë (5) viteve është i aplikueshëm. Rrjedhimisht, duke zbatuar nenin 90 paragrafin 1 pikën 4 të KPK-së, parashkrimi skadon pas pesë (5) viteve nga kryerja e veprës penale. Vepra penale është kryer në mes 12 shtatorit 2007 dhe 8 prillit 2008. Rrjedhimisht, parashkrimi do të skadonte pas pesë (5) viteve duke vazhduar prej 8 prillit 2008. Prandaj, më 10 gusht 2010 kur është ngritur aktakuza kundër të pandehurit parashkrimi nuk kishte skaduar.
- 85) Gjithashtu, argumenti i paraqitur në katër kërkesat plotësuese për shqyrtimin e provave plotësuese, të datave 25 shkurt, 28 prill, 18 qershor dhe 10 korrik 2014, hedhen poshtë si pretendime të papranueshme të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 432 paragrafit 2 të KPP-së, sa i përket pretendimeve për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

- 86) Kolegji, pas shqyrtimit të kërkesës së të pandehurit për shtyrjen apo ndërprerjen e zbatimit të aktgjykimit të formës së prerë kundër tij, sipas nenit 435 paragrafit 4 të KPP-së, refuzon kërkesën si të pabazuar.

Një masë e tillë mund të urdhërohet nëse vendimi gjyqësor i formës së prerë përmban shkelje të qarta dhe të rënda të ligjit të cilat do të cenonin në mënyrë të rëndë dhe të pariparueshme të drejtat dhe liritë elementare të personit të dënuar, nëse do të ekzekutohej. Gjykata duhet të marrë parasysh faktin se vendimi në fjalë është shqyrtuar nga shkalla e mëparshme dhe se në interes të drejtësisë dhe efikasitetit gjyqësor çdo shtyrje apo ndërprerje e zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë mund të jetë vetëm një përjashtim i jashtëzakonshëm.

I pandehuri nuk ka mbështetur rrezikun e një dëmi të tillë të pariparueshëm të të drejtave të tij; as gjykata nuk ak gjetur ndonjë shkelje të qartë apo të rëndë në vendimin e formës së prerë të kundërshtuar me kërkesën e të pandehurit që do të mund ta arsyetonte një shtyrje apo ndërprerje të tillë të ekzekutimit. Referencë i është bërë arsyetimit të paraqitur më lart në lidhje me të pandehurin L.P..

5. I pandehuri B.B.

- 87) Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se i pandehuri B.B. është akuzuar vetëm për veprën penale Krim i organizuar sipas nenit 274 paragrafin 2 të KPK-së. Definicioni i kësaj vepre përshkruan vetëm pjesëmarrjen në grup dhe kjo kryerjen aktuale të ndonjë vepre penale. Gjykata nuk ka qenë e autorizuar që ta ri-cilësojë veprën penale në Mashtrim.
- 88) Kolegji gjen se ky argument është i bazuar dhe konsideron se aktgjykimi i formës së peri i kundërshtuar përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 432 nën-paragrafit 1.2 në lidhje me nenin 384 nën-paragrafin 1.10 të KPP-së, që korrespondon me nenin 403 paragrafin 1 nën-paragrafin 10 të KPP-së, kur shpall të pandehurin fajtor për veprën penale Mashtrim në shkelje të nenit 261 paragrafit 1 dhe 2 të KPK-së. Në këtë aspekt aktgjykim tejkalon aktakuzën.
- 89) Aktakuza PPS. Nr. 120/2010, e datës 10 gusht 2010, ka akuzuar të pandehurin B.B. për veprën penale Krim i organizuar në shkelje të nenit 274 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së. Ajo është konfirmuar me aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim të aktakuzës KA. Nr. 304/2011, të datës 23 shtator 2011.

Aktakuza përshkruan kontributin e të pandehurit në veprën penale si në vijim:

“Prej 12 shtatorit 2007 deri më 08 prill 2008...B.B., specialist i ortopedisë – traumatologjisë, i pensionuar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vetën dhe të tjerët në dëm të tjerëve– Fondit Garantues të Kosovës, në Prishtinë, ka vepruar në kuadër të grupit të organizuar kriminal, ... B.B. si anëtar i grupit të organizuar kriminal ka ndihmuar K.P. ... në shpërdorimin e pozitës zyrtare ... K.P. më tutje ka caktuar ekspertim mjekësor, të pandehurin B.B., të cilit ia siguronte shkresat e lëndës në banesën e tij në Prishtinë, dhe ky i fundit në marrëveshje me K.P. në mënyrë të kundërligjshme ka dhënë mendimin e tij profesional, në shkelje të akteve normative dhe pozitive. Duke vepruar kështu, në bazë të fletë-lëshimit të falsifikuar ka dhënë mendimin e tij përkatës, se gjoja F.G. ka

pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja për shëndetin e tij: ka pësuar frikë, deformim, zvogëlim permanent të aktiviteti vital, zvogëlim të aftësisë për punë, ka nevojë për ndihmën e personit të tretë, ushqyerje të detyruar dhe mjekim të mëtutjeshëm. ...”

Neni 305 i KPPK-së, ligji në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës PPS. Nr. 120/2010, përmend elementet esenciale të cilat duhet t'i përmbajë aktakuza. Paragrafi 1 pika 4 e dispozitës përcakton se aktakuza do të përmbajë:

“Kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;”

Aktakuza ngarkon B.B. vetëm për veprim në kuadër të grupit të organizuar kriminal, duke ndihmuar K.P. në shpërdorimin e pozitës së tij zyrtare. Aktakuza në lidhje me të pandehurin B.B. nuk përshkruan elementet objektive esenciale të veprës penale Mashtrim, si aktin e mashtrimit të personit tjetër apo mbajtjen e personit në mashtrim, mjetet e përfaqësimit të rremë apo fshehjen e fakteve dhe shtytjen e viktimës që të veproj në atë mënyrë apo të abstenoj nga veprimi në dëm të pronës së tij apo saj apo pronës së personit tjetër, as nuk përmend asnjë element subjektiv korrespondues - dashjen për kryerjen e këtyre veprimeve – të kërkuar me nenin 261 paragrafin 1 të KPK-së. Gjykata e Qarkut sipas nenit 386 paragrafit 2 të KPPK-së nuk ka qenë e obliguar me cilësimin juridik të aktit në aktakuzë. Sidoqoftë, ri-cilësimi të cilin turpi gjykues ka qenë i lejuar që ta bëjë është dashur të korrespondojë me aktin, siç përcaktohet me nenin 305 paragrafin 1 nën-paragrafin 4 të KPPK-së, i cili në fakt është objekt i akuzës. Në këtë lëndë, me ri-cilësimin e veprës penale si Mashtrim sipas nenit 261 paragrafit 1 të KPK-së, gjykata ka tejkaluar aktakuzën. Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me këtë dhe nuk e ka korrigjuar shkeljen.

90) Mendimi i këtij kolegji të Gjykatës Supreme është se në këtë fazë të procedurës (që është mjet i jashtëzakonshëm juridik) Gjykata Supreme nuk është e autorizuar që ta ndryshoj cilësimin juridik të akteve të të pandehurit pa e njoftuar atë dhe pa i ofruar mundësinë për mbrojtje efektive. Prandaj, kolegji është dashur ta lirojë të pandehurin nga akuzat penale të formuluar në aktakuzë.

91) Rrjedhimisht, duke zbatuar nenin 438 nën-paragrafin 1.1 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës ndryshon aktgjykimin e Gjykatës së Apelit duke e liruar të pandehurin B.B. nga të gjitha akuzat penale.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si në dispozitiv.

Kryetare e kolegjit:

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtarët e kolegjit:

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it

Procesmbajtës:

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.-Kzz. Nr. 170/2014
Prishtinë
11 shkurt 2014